



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 153 dt.10.08.1994

PER
RRITJEN E PAGAVE TE KESHILLAVE DREJTUESE TE
NDERMARRJEVE LOKALE TE INDUSTRISE

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.10.08.1994, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Seksioni i Prognozës “Për rritjen e pagave të këshillave drejtuese të ndërmarrjeve lokale të industrisë”, në zbatim të vendimit të K.Ministrave Nr.623, dt.31.12.1993. Mbështetur në kopetencat që i jep këtij Këshilli ligji “Për ndërmarrjet shtetërore” Nr.7582, dt.13.07.1992, neni.19, pika.5 dhe ligji Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, neni.14, pika.10

VENDOSI

1. Aprovimin e pagave të mëposhtëme :

1.Dega Kimi – Qelq, Ndërmarrja Kimike :

- Paga e drejtorit aprovet 7.200 lekë/muaj.

2.Për Ndërmarrjen e Prodhimit Kristal Ujë – Xhami

- Paga e drejtorit të jetë 7.000 lekë në muaj.

2. Dega Artistike Veshje

- Për Ndërmarrjen Artistike të Alabastrës
- Paga e drejtorit të jetë 6.500 lekë/muaj.
- Për ndërmarrjen e Prodhimit të Xhupa – Doreza
 - Paga e drejtorit të jetë 7.500 lekë/muaj (Ndërmarrja që punon me lëndën e parë të porositësit).

3. Ndërmarrje të Industrisë Lehtë

- Ndërmarrja e Prodhim të Artizanatit Nr.2
 - Paga e drejtorit të jetë 6.500 lekë/muaj

4. Për anëtarët e këshillit drejtues kur kanë detyrën e K/Degës Ekonomike apo teknike, paga e tyre të jetë 15 përqind më e vogël se ajo e drejtorit, ndërsa për specialistët anëtarë të k.drejtues paga e tyre të jetë 20 përqind më e vogël se paga e drejtorit.
5. Në zbatim të V.K.M. Nr.623, dt.31.12.1993, drejtori i ndërmarrjes dhe anëtarët e këshillave drejtuese, përfitojnë rritje rroge mbi 5 – 50 përqind me të njëjtën masë që përfitojnë dhe punonjësit e tjerë.
6. Këto paga sipas ligjit në fjalë fillojnë të zbatohen që nga 1 Janari 1994.

KRYETARI

BESNIK PETRELA